

## Christophe Solioz: Kosova anëtare e OKB-së, jo para vitit 2030

Gjenevë, 4 mars (AIP) - Prof.dr. Christophe Solioz, sekretar i përgjithshëm i Qendrës Evropiane për Strategji dhe Integritim (CEIS) në Gjenevë, është ekspert i OKB-së dhe OSBE-së, nëherit njohës i mirë i zhvillimeve në ballkan autor i një sër publikimesh mbi krizat në rajon, në fillim të bisedës për agjencinë e lajmeve "Presheva Jonë" ka pohuar se "çështja e pamvarësisë së Kosovës është një akti i pamohueshëm, por pyetja tashmë nuk qëndron aty, por se si mund ta përforcojmë atë dhe ta avancojmë. Unë përkrahu pavarësinë e Kosovës, por jo këtë pavarësi cfarë është sot e cila ka stagnuar proceset, me theks të posaqëm papunësia e madhe, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, ku kjo dukuria e fundit ditë e sa vie po bëhet kancer i këtij shteti më të ri në Evropë."



Se si e vlerësn situatën aktuale në Kosovë, pas 5 vitesh pmavrësi dr.christoph Solioz, sekretar i përgjithshëm i CEIS për "Presheva Jonë" është përgjigjur se "Situata e pasluftës padyshim është shumë më mirë. Por megjithatër në rajon ka mbetur edhe shumë për t'u bërë për të folur për një situatë vërtetë stabile. Si në Kosovë ashtu edhe në Serbi, Maqedoni..me keqardhje e them se në Kosovë ende kemi një situatë të brishtë. Vërtetë kërcënimet e luftës janë tejkaluar por kriza institucionale në Kosovë, Serbi, Maqedoni, në një shkallë më të vogël në Shqipëri janë vende të cilat shqetësojnë jo vetëm popullatën e rajoneve por edhe bashkësinë ndërkombëtare. Sot ndër problemet me shqetësuese për komunitetin ndërkombëtar janë varfëria, korrupsioni dhe krimi i rajonit që ka përfshirë rajonin si në Kosovë ashtu edhe në Serbi e më gjerë."

Megjithatë, sipas professor Solioz, mund të thuhet se jannë bërë gjëra të mira në Kosovë. "Por aq sa janë bërë po aq edhe sjanë bërë përparime dhe Kosova fatkeqësiht edhe vazhdon të mbete vrimë e zezë në ballkan. Pamvarësia e Kosovës ka mbushur pesë vjet por rajoni ende ka probleme në disa sfera si në papunësinë e madhe në rajon, më të madhen në Evropën juglindore, pastaj mungesa e investitorëve të huaj, mos toleranca zero ndaj krimit të organizuar sidomos ndaj korrupsionit që sioq edini edhe pjesëtarë nga kabineti i Thacit janë në shenjështër të policisë së Eulex-it dhe ndërkombëtareve për krim të organizuar dhe korrupsion, ku kjo dukuria e fundit ditë e sa vie po bëhet kancer i këtij shteti më të ri në Evropë." shton z.Solioz.

I pyetur rreth dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës në vazhdim z.Solioz pohon se nuk ka altrenativë tjetër pos vazhdimit të këtij procesi. "Takimi i parëmes dy presidentëve të dy vendeve, pra Serbsië dhe Kosovës, pas gjithë asaj cfarë kishin përjetuar, është shpresdhënëse për rajonin. Aq me tepër tash kur ky dialog po vazhdon pas rundeve të njëpasnjshme mes kryemisnitrit serb Dacic dhe atij kosovar Thacit ku me ndërmjetësimin e BE-së po përpjen për normalizimin e mardhënieve mes dialogut i cili deri dje nisi me problemet teknik, dhe tash ka hyrë ne fazën kulmore , atë të çështjeve politike, duke përfshirë ketu edhe Veriun."

Duke folur për situatën në Veri z.Cristof Solioz pohon se strukturat paralele serbe në Kosovë duhet të shuhet dhe të integrohen në shoqërinë kosovare, në institucionet e komunave dhe institucionet e Kosovës. “Unë mendoj se ndarja e Kosovës apo këmbimi i territoreve mes Kosovës dhe Serbisë nuk do të ishte zgjidhje, përkundrazi do të shpiente drejt destabilitetit të rajonit, kur dihet mirëllini ndërtimi dhe struktura e ish-republikave Jugosllave. Prandaj, edhe asociacioni i komunave si ide mund të jetë një zgjidhje e cila sot praktikohet edhe në disa vende të botës, pikërisht në vendet anëtare të BE-së qoftë në Spanjë apo Gjermani..Funksionimi i tyre si komuna të përbashkëta, apo regjionalizimi i rajoneve, siq kemi rastin në Zvicër, nuk don të thotë se ato do të shkëputen nga Kosova, por ato duan të kenë më shumë pushtet, dmth kompetenca dhe të ndjehen më të sigurta në vendimet e tyre..”

Se ky asociacion i komunave apo rrespektimi i reciprocitetit a duhet të vlejë edhe për komunat shqiptare në Luginën e Preshevës z.Solioz pohon se “natyrisht se një gjë e tillë duhet mundësuar edhe minoritetit shiptarë në Serbinë jugore, siq është e njohur tashmë si Lugina e Preshevës..” Flitet se përmes dialogut Serbi-Kosovë kjo e fundit mund të fitoj ulësen në OKB, se si mund të realizohet kjo dhe kur mendon që Kosova të jetë anëtare e Kombeve të Bashkuara , eksperti i OKB-së dhe OSBE-së z.Chriustophë Solioz pohon se për këtë temë ende hertët të flasim dhe se për këtë nuk vendos as Prishtina e as Beogradi

“Qveritarët kosovar para se të flasin për anëtarësimin e Kosovës në OKB ka obligime dhe detyra tjerabshume më urgjente dhe të rëndësishme për t'i kryer. Unë nuk mendoj se Kosova do të pranohet njëherë anëtare e OKB-së, së paku jo para vitit 2030-të. Këtë e them jo pse Kosovën ende nuk e kanë njohur as 100 vende, por Kosova ka ende shumë rekomandime pa realizuar të parashtruara nga komuniteti ndërkombëtar. Dialogu me Kosovës dhe Serbisë nuk sjellë anëtarësimin e Kosovës në OKB, meqë për këtë nuk vendos as Prishtina e as Beogradi por vendet anëtare të OKB-së dhe dihet për momentin se çfarë qëndrimesh ka sot Rusia dhe Kina. Kosova nuk mund të hyjë direkt si anëtare e plotë e OKB-së para se të bëhet fillimisht si vëzhguese që për këtë nevojitet ende kohë. Një gjë jam i sigurt se Kosova kur të bëhet një ditë anëtare e OKB-së ky ekip i Prishtinës zyrtare nuk do të jetë më në qeveri. Sespe popullllata dhe orgnaizat ndërkombëtare kërkojnë njerëz në qeveri jo vetëm me dorza, por edhe me duar të pastra... », ka deklaruar në fund për « Presheva jonë » dr. Chrisoph Solioz sekretar i përgjithshëm i Qendrës Evropiane për Strategji dhe Integritet.